

## Si bëhet konfirmimi në shërbimin civil civil i nëpunësit të emëruar?

Çdo person i emëruar për herë të parë në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive është subjekt i një periudhe prove 1-vjeçare, e cila fillon nga data e fillimit të detyrës. Ky mjet përdoret për të vlerësuar nëse nëpunësi është i përshtatshëm për të punuar në pozicionin e punës ku është emëruar.

Gjatë periudhës së provës, nëpunësi do të ndjekë programin e trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s dhe do të realizojë detyrat nën udhëheqjen e një nëpunësi civil më të vjetër, i cili do të ndihmojë nëpunësin të kryejë detyrat.

Pas marrjes së mendimit me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, eprori direkt është i detyruar të vendosë konfirmimin e nëpunësit civil, nëse ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe është vlerësuar të paktën “kënaqshëm”.

Njësia përgjegjëse nxjerr aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni përkatës.



## Na kontaktoni



04 22 68 141



Rruga “Abdi Toptani”,  
ish-hotel “Drini”,  
Tiranë

kms hc@kms hc.al.



## PROCEDURAT E PLOTËSIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

(PJESA E PARË)

## PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

### Si realizohet konkurrimi për pranimin në shërbimin civil?

Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- Verifikimi paraprak, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.
- Vlerësimi i kandidatëve.

### Si vlerësohen kandidatët?

Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen:

- Vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës dhe trajnimeve, të lidhura me fushën.
- Vlerësimi nga testimi me shkrim.
- Vlerësimi nga intervista e strukturuar me gojë.

### Sa është afati për të ushtruar të drejtën e ankimit për moskualifikim?

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë një ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për moskualifikimin e tij.

Njësia përgjegjëse duhet t'i kthejë përgjigje ankuesit brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

### Kush e nxjerr aktin e emërimit në detyrë dhe cilat janë efektet ligjore të tij?

- Akti i emërimit nxirret nga njësia përgjegjëse, që është DAP-i për institucionet e administratës shtetërore dhe njësia e burimeve njerëzore për institucionet e pavarura dhe bashkitë.
- Akti i emërimit del pas marrjes së miratimit zyrtar nga ana e kandidatit fitues dhe dorëzimit prej tij të formularit të vetëdeklarimit (formulari i dekriminalizimit). Kandidati fitues i procedurës së pranimit në shërbimin civil emërohet nëpunës civil në periudhë prove.
- Kandidati fitues detyrohet të paraqitet pranë institucionit ku është emëruar jo më vonë se 5 ditë pune nga data e komunikimit të aktit të emërimit.
- Në rast të mosparaqitjes së kandidatit fitues në institucionin ku është emëruar, brenda 5 ditëve kalendarike nga momenti i komunikimit të aktit të emërimit, institucioni njofton brenda 5 ditëve pune njësinë përgjegjëse.
- Njësia përgjegjëse me marrjen e njoftimit për mosparaqitje në punë të nëpunësit të emëruar fillon dhe ndjek procedurën për anulimim e aktit të emërimit duke respektuar dispozitat përkatëse të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

### Kur fillojnë efektet financiare të kandidatit të emëruar?

- Institucioni pasi merr aktin e emërimit, brenda 5 ditëve pune nga data e paraqitjes së nëpunësit të emëruar detyrohet të nxjerrë aktin e fillimit të marrëdhënieve financiare.
- Ky afat mund të shtyhet me marrëveshje midis 2 palëve, por jo më shumë se një muaj nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit nga njësia përgjegjëse.

